

Proces-Verbal për përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit ,kritereve të vlerësimit dhe specifikimeve teknike

Objekti i prokurimit: **Ndërtimi i mjediseve sportive/ fushe sportive, pranë shkollës 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”**

I mbajtur sot më datë 21.02.2023 , nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga Bledar Methoxha (Kryetar), Ernest Ymeri (Anëtar) dhe Erigerta Hebibasi (Anëtare), në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 1 dhe pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit dhe kritereve të vlerësimit , si dhe specifikimeve teknike, për procedurën e hapur e thjeshtuar, punë, me objekt: **Ndërtimi i mjediseve sportive/ fushe sportive, pranë shkollës 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”**.

A. Kriteret e vlerësimit

Njësia e prokurimit pasi u njoh me projektin e zbatimit, preventivin e punimeve, grafikun e punimeve dhe specifikimet teknike për objektin e prokurimit **“Ndërtimi i mjediseve sportive/ fushe sportive, pranë shkollës 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”**”, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, vendos që kriter i vetëm i vlerësimit të jetë:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Argumentimi:

(në zbatim të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 3. ku përcaktohet “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”).

B. Kriteret e përzgjedhjes/ kualifikimit

Njësia e prokurimit, në zbatim Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe Dokumenteve Standarte për Procedurën e hapur të thjeshtuar, punë, shtojca 7, të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, si dhe duke patur parasysh llojin , sasinë dhe natyrën e punëve që prokurohen, vendos që kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, duke i argumentuar hap pas hapi, të jenë si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

1.1 Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

1.2 Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

1.3 Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

1.3.1 Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

1.3.2 Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim, si dhe t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk

ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, si dhe Dokumenteve Standarte për Procedurën e hapur të thjeshtuar, punë, shtojca 7, të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik.)

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është është në masën 2% të fondit limit ose e shprehur në lekë 90,439 (nëntëdhjetë mijë e katërqintë e tridhjetë e nëntë).*
- c) *Formularin e ofertës, sipas shtojcës 1*
- d) *Preventivin e punimeve, sipas shtojcës 2*

Autoriteti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

2.1.1 Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithsme të kualifikimit, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Operatorët ekonomikë duhet të garantojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duke përmbushur kërkesat e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të objektit të prokurimit.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 dhe pika 2 gërma c)).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për dy vitet e fundit financiare, 2020, 2021, që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.)

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore që nuk kanë detyrime të pashlyera për vitin 2021 dhe 2022. Ky vërtetim kërkohet për Njësinë Vendore ku Operatori Ekonomik ka të regjistruar selinë qendrore, si dhe për të gjitha Njësitë Vendore ku Operatori Ekonomik ka ushtruar aktivitetet gjatë këtyre dy viteve.

2.3 Kapaciteti teknik

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë, duhet të garantojnë që zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie, duke përmbushur kërkesat si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe:

1. Situacionin përfundimtar të objektit;
2. Akt kolaudimi objekti;
3. Çertifikaten e marrjes në dorezim të objektit

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, si dhe:

1. Situacionin përfundimtar të objektit;
2. Aktin e kolaudimit;
3. Faturat tatimore përfundimtare

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni

55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pika 4, gërma a) si dhe për të përcaktuar saktë natyrën e punimeve të ngjashme të realizuara me sukses)

2.3.2 Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore , e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë.
 N.P – 2 A Ndërtime civile e industrial.
 N.P – 11 A Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

PUNIME SPECIALE NË NDËRTIM

- N.S -1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
 N.S – 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike e druri.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 6 gërma a), VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar si dhe në përputhje me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve.)

2.4 Staf i dhe punonjësit

2.4.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit (Dhjetor 2022-Janar 2023), si dhe të shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë përkatëse, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

2.4.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar në profesionet si më poshtë:

Teknik i mesëm ndërtimi	1 (një)
Elektriçist	1 (një)
Saldator dhe prerës të metaleve	1 (një)
Hekurkthyes	2 (dy)
Karpentier	2 (dy)
Nivelues betoni	2 (dy)
Bojaxhi	1 (një)
Drejtues të automjeteve të rënda (Kat C)	1 (një)

Manovrator mjetesh te renda	1 (një)
-----------------------------	---------

a) Për secilin specialist duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Dëshmi kualifikimi profesionale, diploma ose certifikata, lëshuar nga institucione të licënuara nga organet përkatese.
- Listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Dhjetor 2022-Janar 2023) në të cilat duhet të figurojnë specialistët e sipërpërmëndur.

b) Për manovratorët dhe drejtuesit e automjeteve të rënda, të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit e lëshuar nga DPSHTRR.
- Listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Dhjetor 2022-Janar 2023) në të cilat duhet të figurojnë manovratorët dhe drejtuesit e automjeteve të rënda të sipërpërmëndur

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje prej punonjësve të mësipërm si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

2.4.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar për të paktën **12 (dymbëdhjetë)** punonjës, përveç stafit drejtues, inxhinierëve të kërkuar në pikën 2.4.1, teknikëve të ndërtimit, si dhe drejtuesve të automjeteve të rënda dhe manovratorëve të kërkuar në pikën 2.4.2 për periudhën Dhjetor 2022-Janar 2023.

Për këtë të paraqitet:

- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën e sipërcituar.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin Publik", neni 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike", pika 6 gërma c) dhe ç), si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve.)

2.5 Mjetet dhe paisjet.

2.5.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin në kohë dhe me sukses të punimeve, si më poshtë:

	Paisje e makineri	Njësia	Sasia	Pronësia
1	Ekskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kokë tërheqëse + rimorkio për transport makinash	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Auto vetshkarkuese 5-7.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Rul ngjeshes	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Kamion me vinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Depozitë uji	copë	1	Në pronësi ose me qera

7	Autobetoniere kantieri 2-3 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Vibrator betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Elektrosaldatriçe	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Betonforma	m ²	50	Në pronësi ose me qera
11	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Instrument gjeodezik	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Skele inventari	m ²	100	Në pronësi ose me qera
15	Paisje per perzierjen e tartanit	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Paisje per shtrimin e tartanit	copë	1	Në pronësi ose me qera

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
- dokumentacioni që verteton rregjistrimin e mjetit leja e qarkullimit;
 - çertifikatën e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - leja e transportit e vlefshme
 - foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij;
- (b) Për mjetet e mara me qira, krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën a), duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e noterizuar e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse dhe fotot.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 6 gërma d) , si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve në të cilin janë paracaktuar fuqia punonjëse e nevojshme si dhe mjetet dhe paisjet si më poshtë:

	Paisje e makineri			Përshkrimi i punës
1	Ekskavator me goma	copë	1	Për përhapjen e çakullit
2	Kokë tërheqëse + rimorkio për transport makinash	copë	1	Për transportin e rulit dhe ekskavatorit
3	Auto vetshkarkuese 5-7.5 ton	copë	1	Për transportin e dheut të gërmuar, transportin e çakullit për shtresat, gurëve etj.
4	Rul ngjeshes	copë	1	Për ngjeshjen e shtresës së çakullit
5	Kamion me vinç	copë	1	Për transportin dhe shkarkimin e çimentos, elementeve metalike etj.
6	Depozitë uji	copë	1	Për ujin që do prodhohet betoni

7	Betoniere kantieri 2-3 m ³	copë	1	Për prodhimine betonit te shtreses, shkallëve etj.
8	Vibrator betoni	copë	2	Për vibrimin dhe ngjeshjen e betonit
9	Elektrosaldatriçe	copë	1	Per punimet e saldimit te konstruksioneve metalike
10	Betonforma	m ²	50	Për ndërtimin e betoneve, shtreses, shkallëve etj.
11	Matrapik	copë	1	Për punimet e prishjeve të betonit
12	Instrument gjeodezik	copë	1	Për kuotat dhe sistemimin (etj)
13	Gazogjen	copë	1	Per punimet e saldimit te imta ndryshme
14	Skele inventari	m ²	100	Per pun. ne lartesi (saldimet, lyerjet, punimet elektrike, etj)
15	Paisje per perzierjen e tartanit	copë	1	Për përgatitjen e tartanit të fushës
16	Paisje per shtrimin e tartanit	copë	1	Për shtrimin e tartanit të fushës

2.6 Kërkesat e cilësisë

2.6.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë, ose ekuivalente me to:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (ose ekuivalente)
- ISO 45001-2018 (Siguria dhe shëndeti në punë) (ose ekuivalente)

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentimi:

(Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 “Kërkest e cilësisë”, pika 1).

3. TË PËRGJITHSHME

Në zbatim të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , neni 26, pika 6 “Formulari përmbledhës i deklaramit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit, të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 1 “Kriteret e përgjithëshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, të deklaruara në formularin përmbledhës të deklaramit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

C. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti i prokurimit: **“Ndërtimi i mjediseve sportive/ fushe sportive, pranë shkollës 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”**”, shoqërohet me projekt zbatimi të plotë, specifikime teknike, grafik punimesh dhe preventiv punimesh.

Specifikimet teknike, në një dokument prej 42 faqesh, sqarojnë të gjitha kërkesat e projektit për materialet, mënyrën e kryerjes së punimeve etj. Ato përmbajnë 6 kapituj si më poshtë:

- KAPITULLI 1 - TË PËRGJITHSHME
- KAPITULLI 2 – GËRMIMET
- KAPITULLI 3 – PUNIMET E SHTRESAVE
- KAPITULLI 4 – BETONET
- KAPITULLI 5 – PUNIMET ELEKTRIKE
- KAPITULLI 6 – KONSTRUKSIONET METALIKE

Specifikimet Teknike do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte te Tenderit, për procedurën e hapur të thjeshtuar, punë.

Për pasojë, kërkesa e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e plotësuar.

D. Përfundime

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit , si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte te Tenderit, për procedurën e hapur të thjeshtuar, punë me objekt prokurimi **“Ndërtimi i mjediseve sportive/ fushe sportive, pranë shkollës 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”**”. Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Kryetar
Bledar Methoxha

Anëtar
Ernest Ymeri

Anëtar
Erigerta Hebibasi